

Këtë vit...\*



ONE është...



**Dhe për më shumë !**

## ONE ZYRA E LINDJES DHE E FËMIJËRISË

REDAKTOR PËRGJEGJËS  
Benoît PARMENTIER

REALIZIMI  
ONE

EDSDE0625  
D/2017/74.80/25



### Na kontaktoni :

[www.one.be](http://www.one.be), [info@one.be](mailto:info@one.be) ose  
Administratën nënrajonale të ONE-së  
të provincës suaj:

Administrata qendrore : 02 542 12 11 - [info@one.be](mailto:info@one.be)

Bruxelles : 02 511 47 51 - [asr.bruxelles@one.be](mailto:asr.bruxelles@one.be)  
 Brabant wallon : 02 656 08 90 - [asr.brabant.wallon@one.be](mailto:asr.brabant.wallon@one.be)  
 Hainaut : 065 39 96 60 - [asr.hainaut@one.be](mailto:asr.hainaut@one.be)  
 Liège : 04 344 94 94 - [asr.liege@one.be](mailto:asr.liege@one.be)  
 Luxembourg : 061 23 99 60 - [asr.luxembourg@one.be](mailto:asr.luxembourg@one.be)  
 Namur : 081 72 36 00 - [asr.namur@one.be](mailto:asr.namur@one.be)



## ALBANAIS

# ZYRA E LINDJES DHE E FËMIJËRISË PËR JU DHE FËMIJËN TUAJ.



Informacion për prindërit,  
pritje dhe shoqërim i familjeve,  
mbështetje prindërve.  
...



Zyra e Lindjes dhe e Fëmijërisë është organizmi bazë i Federatës Walloni Bruksel (Komuniteti francez i Belgjikës) për të gjitha në lidhje me fëmijën, i politikave për fëmijët, për mbrojtjen e nënës dhe fëmijës, të shoqërimit mjekësor-social të nënës(së ardhëshme) dhe fëmijës, të pritjes së fëmijës jashtë hapësirës familjare dhe të mbështetjes së prindërve.

ONE është këtu për t'ju përgjigjur pyetjeve tuaja.


ONE ka botuar broshura informacionesh për tema të ndryshme (ushqimi, gjumi, zhvillimi i fëmijes...) dhe organizon aktivitete mbi këto tema.

ONE bashkëkrijon, gjithashtu, emisione televizive destinuar prindërve.

Falas dhe e hapur për të gjithë, shërbimet e ONE-së janë ngritur pranë jush.



\*Shifrat 2016  
\*\*ONE zhvillon një aksion parandalues të keqtrajtimit të fëmijëve në sajë të ekipeve SOS Fëmijë





# NËSE JU DËSHIRONI, ONE MUND T'JU MBËSHITESË E T'JU SHOQËROJË NË ROLIN TUAJ PRINDËROR

## Planifikoni një bebe

**Të bësh një bebe, kjo do përgatitje!**  
ONE-ja zhvillon fushata ndërgjegjësimi mbi rëndësinë e vizitës para shtatzënisë  
**Pyetje në lidhje me adoptimin?**  
ONE-ja ka një shërbim adoptimi që shoqëron prindërit që linden, fëmijët e adoptuar dhe familjet që adoptojnë. Ai realizon adoptimin e fëmijëve të lindur ose banues në Bruksel dhe në Walloni.

## Në kërkim të një vendi pritës për fëmijën tuaj?

**Ju prisni një bebe ....**  
**Një aventurë prej nëntë muajsh fillon....**

### Konsultimet e paralindjes

Këto konsultime janë vende të hapura për të gjithë prindërit e ardhshëm. Ato vende në spital ose në lagjen tuaj.



Atje ju do të pritëni nga një gjinekolog ose një mami dhe një punonjës mjekësor-social (TMS-PMS). Ky është asistent social (m/f) ose infermier (m/f)

Ata ndjekin progresin e shtatzënisë, verifikojnë zhvillimin e bebes dhe gjithashtu bëjnë kujdes për shëndetin e nënës së ardhshme.



Mjeku do të realizojë një seri ekzaminimesh (analizë gjaku, ekografi...). PMS do t'ju përgjigjet me kënaqësi pyetjeve tuaja, do t'ju japë shumë informacione për shtatzëninë, procesin e lindjes, si dhe për ndihmën e parë i jepet fëmijës. Ai mund të vijë në banesën tuaj për të folur me ju për lindjen e fëmijës suaj ose t'ju drejtojë në veprimet tuaja administrative (shpërblimi për lindjen...). Ai mund t'ju ndihmojë, gjithashtu, në përfytyrimin e rolit tuaj të ardhshëm si prindër.


Gjatë vizitës suaj të parë, ju do të merni librin « TË BËHESH PRIND ». Ky libër ka përgjigjet e pyetjeve që bëjnë prindërit (e ardhshëm). Ju do të merni, gjithashtu « LIBRIN E NËNËS », dritarin e shtatzënisë. Ruajeni atë me kujdes! Ai do të shërbejë si lidhje midis të gjithë specialistëve të shëndetit që do t'ju shoqërojnë gjatë këtyre 9 muajve



## Bebja sapo lindi ...

### Gjithë urimet tona !

### Në maternitet



Në shumicën e materniteteve , një PMS i ONE-së do t'ju prezantojë shërbimete ofruar nga ONE-ja pas lindjes së fëmijës suaj.  
Ai do t'ju japë njëkohësisht **LIBRIN E FËMIJËS** (i quajtur gjithashtu « libri i shëndetit të fëmijës »).

### Konsultimet për fëmijët

Konsultimet për fëmijët janë falas dhe në dispozicion për të gjithë prindërit dhe fëmijët nga 0 deri 6 vjeç. Ata kanë për qëllim të sigurojnë monitorimin e shëndetit të fëmijës suaj. Një ekip i formuar nga një mjek, një PMS dhe vullnetarë do t'ju presin për të realizuar, me takime, një seri ekzaminimesh mjekësore (vaksina, depistimit pamor...). Ata do të përgjigjen, gjithashtu, të gjitha pyetjet që ju do të bëni. Ata, pra, mund t'ju ndihmojnë për rolin tuaj prindëror.



Shumë aktivitete organizohen në këto konsultime (konferenca, lojra, lexim, vende për të folur...) Këto aktivitete shërbejnë si raste për të takuar prindërit të tjerë e të ndani, kështu, eksperiencat tuaja. Për më tepër, nëse dëshironi, PMS mund të vijë në banesën tuaj ose t'ju presë për gjatë orarit të shërbimit të tij. Në disa rajone, ekzistojnë makina shëndetësore. Këto janë konsultime « të lëvizëshme » duke ofruar të njëjtin shërbim si konsultimet fikse.

### Shkolla e detyrave.



Shkollat e detyrave (EDD) mbështesin të mësuarin dhe punën shkollë të fëmijës suaj duke zhvilluar aktivitete edukative, pedagogjike, krijuese, argëtuese sportive dhe kulturore. Fëmijët janë të mirëpritur nisur nga 6 vjeç deri 12,15 ose ndonjëherë 18 vjeç



### PROMOVIMIN E SHËNDETTIT

ONE gjithashtu nxit shëndetin në shkollë përmes konsultimeve mjekësore parandaluese me studentët dhe aktivitetet për promovimin e shëndetit

- 9 muaj

- 8 muaj

- 7 muaj

- 6 muaj

- 5 muaj

- 4 muaj

- 3muaj

- 2muaj

- 1 muaj

0 vjeç

1 vjeç

2 vjeç

3 vjeç

4 vjeç

5 vjeç

6 vjeç

7 vjeç

8 vjeç

9 vjeç

10 vjeç

11 vjeç

12 vjeç

15 vjeç

20 vjeç

## Mendonni të regjistroni fëmijën tuaj në vendet e pritjes që prej muajit të 4-t të shtatzënisë!

## Çerdhe, pritje ...

### ONE dhe Vendet e Pritjes

ONE autorizon, shoqëron, vlerëson dhe kontrollon Vendet e Pritjes

### Llojet e Vendeve të Pritjes ?

Në një kolektiv ose në një mjedis familjar.



### Çmimi?

Çmimi përcaktohet sipas të ardhurave të prindërve (shkalla ONE për Vendet e Pritjes të financuara) ose pa pagesë (për të tjerët).

## Fëmija juaj rritet ...



### Pritje në kohën e lirë ...

Jashtë orarit të shkollës dhe gjatë pushimeve, ONE-ja ndjek cilësinë e pritjes së fëmijës jashtë orarit të mësimëve ( pritja jashtëshkollë, shkolla e detyrave, qendrat e pushimeve...).

### Pritje jashtë shkollë




Pritje jashtë shkollë, destinuar fëmijëve prej 2,5vjeç deri 12vjeç, organizohen gjatë vitit shkollor, kryesisht nëpër shkolla.

Këto ju mundësojnë që të harmonizoni më mirë jetën tuaj profesionale me atë private; i ofrojnë fëmijës suaj mundësiira të shumta zhvillimi. Për t'u aprovuar nga ONE, ato duhet të përmbushin disa kriteret të cilësisë dhe të aksesibilitetit.

Nëse ju kërkoni informacione më të përgjithëshme, duhet të dini se shumica e komunave koordinojnë pritjen e fëmijëve më të mëdhenj se 2,5vjeç, ju mund të kontaktoni me koordinatorin e ATL (jashtëshkollor).

### Qendra pushimesh



Së shpejti pushimet ?  
Ju dëshironi të gjeni aktivitete të mbikëqyruara për fëmijët tuaj?  
Mendonni për qendrat e miratūra të pushimeve ! Kampet, vendqëndrimet, sheshet e lojrave ofrojnë mundësi reale fëmijëve për të kaluar pushimet e tyre në një mjedis kolektiv, disponueshëm dhe edukativ, me një drejtim dhe animacion cilësor.

Për më shumë : ONE-ja shoqëron dhe kontrollon organizatorët e qendrave të miratuara të pushimeve.